



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 127

Tiranë – E hënë, 26 shtator 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 610, datë 22.9.2022	Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve..... 16093
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 613, datë 22.9.2022	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit për zhvillimin e integruar urban dhe turizmin, ratifikuar me ligjin nr. 19/2017..... 16118



VENDIM
Nr. 610, datë 22.9.2022

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
TË DETAJUARA PËR MËNYRËN E
CAKTIMIT TË MBIKËQYRËSIT,
DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E TIJ,
KUSHTET DHE ELEMENTET E
PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT TË
PËRGJEGJËSISË PROFESIONALE, SI
DHE RREGULLAT, PROCEDURAT DHE
MËNYRËN E MBAJTJES SË
DOKUMENTACIONIT GJATË
ZHVILLIMIT TË PUNIMEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 7/1, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
RREGULLAT PËR CAKTIMIN E
MBIKËQYRËSIT

Neni 1

1. Mbiqëqyrja e punimeve bëhet për të gjitha llojet e objekteve të ndërtimit dhe kryhet nga mbiqëqyrës/grupi i mbiqëqyrësve të punimeve, i cili ka përgjegjësi kontrollin e mbarëvajtjes të të gjithë procesit të zbatimit të punimeve, në përputhje me projektin, rregullat dhe standardet teknike të projektimit, zbatimit, si dhe destinacionin e objektit, duke pasur parasysh edhe anën ekonomike të tij.

2. Mbiqëqyrja e punimeve kryhet nga persona fizikë apo juridikë, vendas apo të huaj, të licencuar për ushtrimin e mbiqëqyrjes së punimeve, të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe të pajisur me NIPT.

Neni 2

1. Mbiqëqyrësi i punimeve/grupi i mbiqëqyrësve caktohet nga zhvilluesi, sipas subjekteve të

regjistruara në regjistrin elektronik të profesionistëve të regjistruar.

2. Caktimin e mbiqëqyrësit/grupit të mbiqëqyrësve, zhvilluesi e kryen duke pasur parasysh llojin e punimeve që do të mbiqëqyren në zbatimin e veprës. Mbiqëqyrësi/grupi i mbiqëqyrësve caktohet në bazë të licencës profesionale të mbiqëqyrjes që disponon dhe pikëve të kualifikimit, të cilat përkojnë me zërat e punimeve që do të kryhen në objekt.

Neni 3

Në rastet kur autoritetet publike investojnë dhe realizojnë një zhvillim në një zonë të caktuar, mbiqëqyrësi i punimeve/grupi i mbiqëqyrësve përzgjidhet nga autoriteti publik në përputhje me rregullat e parashikuara nga legjislacioni për prokurimin publik në fuqi.

Neni 4

Tarifa për shërbimin e mbiqëqyrjes, për vepra publike, të financuara me fonde publike apo private, llogaritet në përputhje me tarifat në fuqi për shërbimin në planifikim territori, projektim, mbiqëqyrje dhe kolaudim. Tarifa për shërbimin e mbiqëqyrjes, me financim nga subjekte private, nuk mundet të jetë më e vogël se tarifa minimale referuese në fuqi. Në rastet e shtyrjeve të afateve kontraktuale, për shërbimin e mbiqëqyrjes llogaritet tarifë shtesë për kohën e shtyrjes së kontratës, sipas legjislacioneve në fuqi sipas fushës, për të cilën kërkohet shërbimi shtesë.

Neni 5

1. Zhvilluesi lidh kontratë me mbiqëqyrësin e punimeve, duke përcaktuar detyrimet e ndërsjella, kushtet e punës, tarifën, rastet e zëvendësimit, sipas pikës 2, të nenit 6, të këtij vendimi, dhe detyrimin e mbiqëqyrësit për të raportuar pranë autoriteteve çdo 45 (dyzet e pesë) ditë për gjendjen e zhvillimit të punimeve.

2. Mbiqëqyrësi i punimeve vihet në dijeni nga zhvilluesi për kontratën e lidhur me zbatuesin e punimeve dhe të nënkontraktorëve të mundshëm që zgjedh zbatuesi i punimeve, në përputhje me kontratën e nënshkruar.



Neni 6

1. Mbikëqyrësi i punimeve nuk zëvendësohet, me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 2, të këtij neni.

2. Zhvilluesi mund të kërkojë zëvendësimin e mbikëqyrësit të punimeve, vetëm në rastet kur:

a) ka mangësi në plotësimin e detyrave të kontrollit të mbarëvajtjes të të gjithë procesit të zbatimit të punimeve, në përputhje me projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit, duke pasur parasysh dhe anën ekonomike të tij;

b) ka ndërprerje të paarsyeshme të punimeve dhe zgjatje të pajustificuar të tyre;

c) ka mangësi kontrolli në koston e kontabilitetit, tolerimin e materialeve me vlera mbi ato të preventivuara dhe/ose me cilësi më të dobët se ajo e përcaktuar në projekt;

ç) nuk kryen raportimet sipas këtij vendimi;

d) ka pamundësi për kryerjen e detyrës për shkaqe shëndetësore, e vërtetuar nga komisioni kompetent mjekësor;

dh) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.

3. Në rastin e zëvendësimit të mbikëqyrësit të punimeve, mbahet procesverbali i dorëzimit të dosjes së punimeve, ku shënohen edhe shkaqet e këtij zëvendësimi. Dokumentacioni i mbikëqyrësit të vjetër i dorëzohet mbikëqyrësit të ri. Njoftimi i mbikëqyrësit të ri kryhet *on-line* në sistemin e-leje.

KREU II

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E
MBIKËQYRËSIT TË PUNIMEVE

Neni 7

Mbikëqyrësi i punimeve në bashkëpunim me zbatuesin e punimeve programon punimet që do të kryhen në objekt nëpërmjet një plani të shprehur në grafik për çdo muaj. Ai mbikëqyr grafikun e punimeve, kontrollon librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumentacionit që mbahet në objekt.

Neni 8

1. Mbikëqyrësi ka detyrimin të raportojë te zhvilluesi, çdo 45 (dyzet e pesë) ditë për kryerjen e punimeve, sipas fazave të akteve të kontrollit, në përputhje me nenin 42, të këtij vendimi.

2. Mbikëqyrësi ka detyrimin të njoftojë *on-line* në sistemin e-leje pranë autoriteteve përkatëse kryerjen e punimeve, sipas fazave të akteve të kontrollit, në përputhje me nenin 42, të këtij vendimi. Ai njofton *on-line* brenda 5 (pesë) ditëve pune në sistemin e-leje pranë autoriteteve përkatëse në rastet kur vëren se punimet e kryera janë në shkelje apo tejkalim të lejes së ndërtimit, si dhe kryen *on-line* çdo 45 (dyzet e pesë) ditë raportimin e kryerjes së punimeve, sipas metodologjisë së përcaktuar nga organi i lëshimit të lejes së ndërtimit.

Neni 9

1. Mbikëqyrësi i punimeve miraton materialet e ardhura në kantier përpara se të vendosen në objekt, nëse ato janë në përputhje me kërkesat e projektit, kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit, standardet e cilësisë së materialeve, si dhe makineritë e pajisjet e siguruara nga zbatuesi i punimeve, të nevojshme në procesin e ndërtimit. Materialet, të cilat nuk marrin miratimin e mbikëqyrësit të punimeve, zëvendësohen me shpenzimet e zbatuesit të punimeve, të cilat duhet të marrin miratimin e mbikëqyrësit të punimeve për t'u përdorur në procesin e ndërtimit.

2. Mbikëqyrësi i punimeve kryen vëzhgimin dhe korrigjimin e detajeve të elementeve të parapërgatitura (parafabrikat), në përputhje me kërkesat e projektit, kushtet teknike të projektimit dhe zbatimit, si dhe standardet e cilësisë së materialeve, të cilat do të përdoren në procesin e ndërtimit.

3. Mbikëqyrësi i punimeve duhet të dokumentojë me procesverbalet e analizave të provave, së bashku me aktin teknik, argumentimin e shmangieve të palejuara, referuar standardeve shqiptare ose në mungesë të tyre standardeve evropiane.

Neni 10

1. Mbikëqyrësi i punimeve njofton zbatuesin e punimeve për porositë, urdhrat dhe udhëzimet e



dhëna në ditarin e objektit gjatë zbatimit të kontratës së punimeve dhe kolaudimit.

2. Mbikëqyrësi i punimeve gjatë zbatimit të objektit i jep instruksione dhe urdhra me shkrim zbatuesit të punimeve sa herë që e sheh të nevojshme, në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fushën e ndërtimit dhe ky i fundit është i detyruar t'i respektojë ato, por duke pasur të drejtën t'i bëjë me shkrim zhvilluesit vërejtjet e tij për instruksionet dhe urdhrat e mbikëqyrësit të punimeve.

3. Mbikëqyrësi i punimeve i kërkon zbatuesit të punimeve të zëvendësojë përfaqësuesit e tij dhe punonjësit e tjerë të kantierit, kur e gjykon dhe e vërteton se ata janë shkak për mosecurinë e punimeve në afat dhe me cilësi, sipas kushteve të kontratës. Për të realizuar këtë, ai i drejtohet me shkrim personit juridik të shoqërisë së zbatimit të punimeve, duke i shpjeguar arsyet. Arsyet kryesore të propozimit për largim mund të jenë moszbatimi i standardeve dhe i rregullave teknike, mosbindja, paafërsia, arbitrariteti në zgjidhjen e problemeve teknike ose pakujdesi të rënda.

Neni 11

1. Mbikëqyrësi i punimeve merr propozimet nga zbatuesi i punimeve për rritje të vlerës së kontratës apo zgjatje të afatit të punimeve dhe ia përcjell ato zhvilluesit për miratim.

2. Në rastin e punimeve shtesë, mbikëqyrësi kërkon nga zbatuesi i punimeve prova dhe inspektime shtesë për të verifikuar konformitetin e punimeve me projektin e specifikimet teknike, sipas kushteve të kontratës. Këto punime shtesë janë objekt i një raportimi të veçantë pranë autoritetit që lëshon lejen e ndërtimit në sistemin *on-line* të lejeve të ndërtimit.

3. Mbikëqyrësi i punimeve njofton zhvilluesin për defektet e konstatuara gjatë zbatimit të punimeve, si dhe për kohën e korrigjimit të tyre.

Neni 12

Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe pranon paraprakisht situacionet pjesore në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të miratuara nga zhvilluesi.

Neni 13

Mbikëqyrësi i punimeve, pasi njoftohet dhe merr propozimet nga drejtori i punimeve për pasaktësitë, mospërputhjet, mungesat e të dhënave në vizatimet, përshkrimet e specifikimet teknike, jep udhëzimet e tij për zgjidhjen e situatës me miratim të projektuesit.

Neni 14

Mbikëqyrësi i punimeve ka të drejtë të kërkojë kryerjen e provave dhe të çdo prove tjetër inxhinierike të nevojshme të materialeve të vendosura në objekt, për të verifikuar cilësinë, kur këto nuk janë kryer në masën, sipas vëllimeve të realizuara. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të zbatuesit të punimeve.

Neni 15

Mbikëqyrësi i punimeve kryen matjet në kantier në bashkëpunim me zbatuesin e punimeve dhe për çdo shmangie të konstatuar mbi atë të lejuarën, të përcaktuar në aktet ligjore për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, pezullon punimet dhe njofton menjëherë zhvilluesin, autoritetin e lëshimit të lejes së ndërtimit dhe Inspektoratin Vendor të Mbrojtjes së Territorit/Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit në sistemin e-leje.

Neni 16

1. Mbikëqyrësi i punimeve, kur gjykon se ka defekte në zbatimin e punimeve, kërkon verifikimet përkatëse. Nëse nga verifikimet rezulton që punimet janë kryer në shkelje të kushteve teknike të zbatimit, të standardeve e specifikimeve teknike, të përcaktuara në projektin e miratuar, ai me miratimin e zhvilluesit urdhëron pezullim të punimeve, për aq kohë sa është i nevojshëm korrigjimi i defekteve, si dhe prishjen e ribërjen e tyre me shpenzimet e zbatuesit të punimeve, brenda periudhës së korrigjimit të defekteve.

2. Në rast se konstatohet që punimet e prishura nuk përbënin shkelje të kushteve teknike të zbatimit, standardeve e specifikimeve teknike, të përcaktuara në projektin e miratuar, zbatuesi i punimeve ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e



shpenzimeve për ribërjen e tyre, e cila mbahet nga sigurimi i profesionit që ka bërë mbikëqyrësi.

Neni 17

1. Mbikëqyrësi pezullon përkohësisht punimet për zbatimin teknik të gabuar ose paaftësi teknike zbatimi, në çdo rast me miratimin e zhvilluesit, për aq kohë sa është i nevojshëm korrigjimi i punimeve me defekt.

2. Kur vërehen shkelje të dispozitave ligjore në fuqi në fushën e ndërtimit, zhvilluesi dhe Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit/ Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, urdhërojnë mbikëqyrësin e punimeve për ndërprerjen e procesit të punës në kantier, deri në përcaktimin e llojit të shkeljes nga IMT-ja dhe deri në përcaktimin dhe marrjen e masave përkatëse për normalizimin e gjendjes.

Neni 18

1. Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon zbatimin e grafikut të punimeve dhe i raporton çdo 45 (dyzet e pesë) ditë zhvilluesit për realizimin e tij, Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit/ Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, si dhe autoritetit që lëshon lejen e ndërtimit.

2. Nëse ai konstaton vonesa në zbatimin e punimeve, njofton zhvilluesin për vonesat në kryerjen e punimeve të shoqëruar me arsyen e këtyre vonesave, edhe në intervalin midis dy raportimeve periodike.

Neni 19

1. Mbikëqyrësi i punimeve njoftohet nga zbatuesi i punimeve kur punimet që do të mbulohen, do të maskohen ose do të betonohen janë gati për t'u kontrolluar prej tij. Me marrjen e njoftimit nga zbatuesi i punimeve, mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe miraton çdo punim përpara se të mbulohet, maskohet ose betonohet.

2. Në rast se mbikëqyrësi nuk njoftohet në kohë dhe punimet për maskimin ose betonimin janë kryer, mbikëqyrësi mban një procesverbal në prezencë të drejtuesit të punimeve, dhe njofton zhvilluesin dhe IKMT-në. Punimet fillojnë pas përcaktimit nga IKMT-ja për ecurinë e procesit të ndërtimit.

Neni 20

Mbikëqyrësi i punimeve bashkëpunon me zbatuesin e punimeve për çmimet e punimeve të reja, që nuk përfshihen në kontratë dhe në kërkesëpropozimin për ndryshimin e saj.

Neni 21

Mbikëqyrësi i punimeve ndërpret punimet për arsye të ndikimit të kushteve klimatike në procesin e ndërtimit, kundrejt një zgjatjeje korresponduese të afatit, sipas kushteve dhe detyrimeve të palëve për ndërprerje të punimeve, të përcaktuara në kontratë.

Neni 22

Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon faturat e blerjes së materialeve dhe të çdo shpenzimi tjetër, që është i lidhur me ndërtimin e objektit, situacionet e paraqitura nga zbatuesi i punimeve në fazat e ndryshme të punimeve, si dhe kontabilitetin.

Neni 23

1. Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe autorizon përdorimin e fondit rezervë, të preventivuar dhe i raporton periodikisht, çdo muaj, zhvilluesit për gjendjen e tij.

2. Zhvilluesi, nëse ka vërejtje në përdorimin e fondit rezervë, njofton zbatuesin e punimeve dhe merr masat e nevojshme për përdorimin e këtij fondi, për të cilin duhet të dakordësohen të dyja palët. Për çdo ndryshim të mundshëm, mbikëqyrësi i punimeve vihet në dijeni nga zhvilluesi për të ndjekur zbatimin e ndryshimeve të dakordësuara.

Neni 24

1. Mbikëqyrësi i dorëzon zbatuesit të punimeve aktin e përfundimit të punimeve dhe rezervat që do të parashtrihen për punimet gjatë kolaudit.

2. Mbikëqyrësi, me kërkesë të zbatuesit të punimeve, vërteton me procesverbal datën e përfundimit të punimeve, sipas projektit, ndryshimeve të mundshme dhe kushteve të kontratës. Ai njofton zhvilluesin për përfundimin e punimeve në objekt.



Neni 25

Mbikëqyrësi i punimeve, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga përfundimi i punimeve, merr nga zbatuesi i punimeve deklaratën teknike për punimet e kryera, e cila nënshkruhet nga drejtuesit teknikë e ligjorë të zbatuesit të punimeve, si dhe përgjegjësi teknik i punimeve në kantiër, bazuar në dokumentacionin teknik të grumbulluar dhe të përpunuar në ndjekjen dhe kontrollin e punimeve.

Neni 26

Mbikëqyrësi i punimeve në bashkëpunim me drejtuesin e punimeve në përfundim të punimeve përgatit dokumentacionin e nevojshëm për kolaudim dhe së bashku me relacionin përfundimtar ia vendos në dispozicion zhvilluesit.

Neni 27

1. Në përgatitjen për kolaudim mbikëqyrësi i punimeve kryen mbikëqyrjen përfundimtare, që konsiston në:

a) përputhshmërinë e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi. Kontrollin në objekt për të verifikuar, nëse ka defekte, të cilat janë brenda afatit të garancisë. Nëse konstaton defekte, kërkon nga zbatuesi i punimeve korrigjimin e tyre, duke përcaktuar një afat kohor, në përputhje me llojin e defektit, para skadimit të afatit të garancisë kontraktuale ose të paktën në dy vitet e para pas pranimit të përfundimeve të punimeve;

b) mbledhjen e vizatimeve dhe llogaritjeve që tregojnë rezultatin përfundimtar të projektit të zbatuar;

c) përgatitjen e raporteve për gjendjen e objektit në bazë të gjetjeve nga kontrolli për aftësinë funksionuese të pjesëve të objektit dhe të objektit në tërësi;

ç) hartimin e listës për pajisjet dhe inventarin;

d) përgatitjen e udhëzimeve për mirëmbajtjen dhe kujdesin e objektit, për kohën deri në marrjen e certifikatës së përdorimit;

dh) mbikëqyrjen e punimeve të mirëmbajtjes për kohën deri në marrjen e certifikatës së përdorimit, por jo më shumë se 2 (dy) vjet;

e) verifikimin e analizës së ndërtimit të objektit dhe funksionimit të tij, shpenzimeve dhe defekteve;

ë) llogaritjen e shpenzimeve për ritarifimin e pagesës së projektimit, mbikëqyrjes dhe kolaudimit;

f) konfirmimin se objekti është në përputhje me lejen e ndërtimit dhe ndryshimet e miratuara.

Neni 28

1. Pas përfundimit të kolaudimit, mbikëqyrësi i punimeve, mbështetur në kontratën dhe në dokumentacionin, përcakton vlerën përfundimtare të objektit, e cila i njoftohet zbatuesit të punimeve dhe ia dorëzon për likuidim zhvilluesit.

2. Për përcaktimin e vlerës përfundimtare të punimeve të kryera në objekt, mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe përllëgarit koston përfundimtare, duke përputhur vlerën e preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe bën sqarimet përkatëse në rastet e mospërputhjes.

KREU III

KUSHTET DHE ELEMENTET E
PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT TË
PËRGJEGJËSISË PROFESIONALE

Neni 29

Mbikëqyrësi i punimeve si person fizik apo juridik, i licencuar, është i detyruar të lidhë një kontratë të sigurimit të përgjegjësisë profesionale. Kontrata e sigurimit të përgjegjësisë profesionale mbulon çdo dëm që mund të shkaktohet si pasojë e veprimtarisë së tij gjatë procesit të ndërtimit të objektit.

Neni 30

Shuma e sigurimit llogaritet në përqindje ndaj tarifës së shërbimit të mbikëqyrjes për kostot e llogaritshme, pa vlerën e tatimit mbi vlerën e shtuar, të përcaktuar në preventivin përfundimtar, i depozituar për të marrë lejen e ndërtimit. Kjo vlerë do të jetë jo më shumë se 20% e vlerës, sipas kontratës së nënshkruar midis zhvilluesit dhe mbikëqyrësit.

Neni 31

Limiti i përgjegjësisë/shuma e sigurimit të kontratës së sigurimit përcaktohet në policën e



sigurimit dhe nuk mund të jetë më i ulët se shuma e sigurimit, sipas përcaktimit në nenin 30, të këtij vendimi.

Neni 32

Shoqëria e sigurimit dëmshpërblen në vlerë monetare të siguruarin/përfituesin për dëmet që ai ka pësuar si pasojë e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit. Dëmshpërblimi nuk kalon në asnjë rast limitin e përgjegjësisë së caktuar në policën e sigurimit, në bazë të pjesës takuese të njësisë individuale dhe asaj të caktuar për palën e tretë.

Neni 33

Maksimumi i shumës agregate të dëmshpërblimit që mund të përfitohet për të gjitha ngjarjet e sigurimit, të ndodhura gjatë periudhës së vlefshmërisë së kontratës së sigurimit, përbën limitin agregat të dëmshpërblimit dhe nuk kalon në asnjë rast limitin e përgjegjësisë së caktuar në policën e sigurimit.

Neni 34

Polica e sigurimit duhet të jetë e përcaktuar për objektin e punimeve, për të cilin mbikëqyrësi siguron profesionin e tij, sipas përcaktimeve në lejen e zhvillimit ose ndërtimit.

Neni 35

1. Kontrata e sigurimit, që lidhet pranë shoqërive të sigurimit nga mbikëqyrësi i punimeve, është e vlefshme për të gjithë periudhën e vlefshmërisë së kontratës së lidhur ndërmjet zhvilluesit dhe mbikëqyrësit.

2. Shoqëria e sigurimit lidh kontratën e sigurimit, me kusht që të përmbushen kërkesat e mëposhtme:

a) Personi fizik apo juridik të jetë i pajisur me licencë për mbikëqyrjen e punimeve që do të realizohen në objekt nga institucioni që ka në fushën e veprimtarisë licencimin për mbikëqyrjen e punimeve në ndërtim;

b) Personi fizik apo juridik i pajisur me licencë për mbikëqyrjen e punimeve të jetë i regjistruar në QKB dhe i pajisur me NIPT;

c) Personi fizik apo juridik mbikëqyrës i punimeve të ketë kontratën me zhvilluesin, të firmosur nga mbikëqyrësi, në rastin e personit juridik nga përfaqësuesi juridik i tij, si dhe përfaqësuesi i zhvilluesit.

Neni 36

1. Shoqëria e sigurimit detyrohet të dëmshpërblejë të siguruarin/përfituesin për dëmtime të ndodhura në objekt, si pasojë e veprimtarisë së mbikëqyrësit gjatë procesit të ndërtimit të objektit, të cilat çojnë, në:

a) shembje tërësore ose pjesore të objektit;

b) rrezik të dukshëm të shembjes së objektit;

c) defekte serioze/të rënda gjatë procesit të ndërtimit.

2. Përfshihen nga e drejta për dëmshpërblim kontraktuesi dhe familjarët e tij, sipas certifikatës familjare, bashkëjetuesi/ja dhe çdo person që bashkëjeton me të.

3. Në rastin kur kontraktuesi është person juridik, përfshihen nga e drejta për dëmshpërblim ortakët/aksionarët dhe përfaqësuesi ligjor/administrator i tij.

Neni 37

Kushte dhe elemente të posaçme shtesë të sigurimit përcaktohen në kontratën e sigurimit.

KREU IV

RREGULLAT, PROCEDURAT DHE
MËNYRA E MBAJTJES SË
DOKUMENTACIONIT GJATË ZHVILLIMIT
TË PUNIMEVE

Neni 38

1. Korrespondenca e mbikëqyrësit të punimeve me zhvilluesin dhe zbatuesin e punimeve është pjesë e dokumentacionit të objektit.

2. Në dosjen e mbikëqyrjes së punimeve pasqyrohen të gjitha aktet e mbajtura gjatë zbatimit të objektit, si akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit, urdhrat e ndryshëm të dhënë nga mbikëqyrësi i punimeve, kundërshtitë dhe kontradiktat e lindura gjatë punës, si dhe zgjidhjet e tyre, ndërprerjet e punimeve dhe shkaqet që kanë diktuar këto ndërprerje, relacionet teknike të kërkuara ose të



paraqitura gjatë zbatimit, si dhe të gjitha rrethanat e nevojshme për të dhënë kuadrin e plotë të të gjitha fazave të zbatimit të punimeve.

Neni 39

1. Mbikëqyrësi i punimeve nëpërmjet drejtuesit të punimeve njihet me librin e kantierit, dokumentacionin e kontabilitetit teknik e të furnizimit të objektit me materiale e produkte ndërtimi, me fotografitë, kasetat filmike dhe çdo dokument tjetër, që provon saktësinë dhe cilësinë e produkteve dhe të punimeve.

2. Mbikëqyrësi i punimeve njoftohet për inspektim të punimeve që do të bëhen të maskuara nga zbatuesi i punimeve për marrjen e kampioneve për kryerjen e provave, të analizave të përcaktuara në rregullat teknike ose të kërkuara shtesë nga vetë ai.

Neni 40

1. Mbikëqyrësi i punimeve para fillimit të punimeve bën verifikimin paraprak, që konsiston në:

a) verifikimin e të gjithë dokumentacionit përkatës, të licencave, autorizimeve dhe lejeve;

b) verifikimin e sheshit të ndërtimit, nëse është i lirë dhe i gatshëm për të filluar punimet;

c) njohjen me hollësi të kontratës së sipërmarrjes dhe të të gjitha akteve administrative që lidhen me të, si dhe njohjen e të gjitha ndryshimeve të mundshme të kësaj kontrate;

ç) marrjen në dorëzim të punës dhe të furnizimeve të materialeve nga zbatuesi i punimeve, duke mbajtur një procesverbal për rezultatin e marrjes në dorëzim;

d) verifikimin, vendosjen e tabelës së identifikimit në kantier me të dhënat e mëposhtme:

i. emërtimi i objektit;

ii. data e marrjes së lejes së ndërtimit;

iii. zhvilluesi;

iv. projektuesi;

v. zbatuesi i punimeve dhe drejtuesi teknik;

vi. mbikëqyrësi;

vii. afati i ndërtimit;

viii. sipërfaqja e ndërtimit;

ix. lartësia (numri i kateve mbi dhe nën tokë).

Neni 41

1. Mbikëqyrësi i punimeve dhe zhvilluesi, për çdo objekt që ndërtohet, administrojnë në kantier dokumentacionin teknik dhe mbajnë përgjegjësi për saktësinë dhe vërtetësinë e tij, si:

a) lejen e zhvillimit, lejen e ndërtimit, së bashku me vendimet përkatëse të lëshuara nga organi kompetent, si dhe me planvendosjen;

b) aktin e dorëzimit të sheshit të ndërtimit, sipas shtojcës i bashkëlidhet këtij vendimi;

c) projektin e zbatimit, të miratuar nga organi, i cili ka këtë të drejtë, sipas juridiksionit dhe oponencën teknike;

ç) preventivin e plotë të projektit të zbatimit, duke përfshirë të gjitha volumet e punimeve, të hartuara nga projektuesit;

d) studimin gjeologo-inxhinierik dhe dokumentacionin topografik të objektit;

dh) studimin sizmik;

e) planorganizimin e punimeve të ndërtimit, i cili përmban planin e ngritjes dhe organizimit të kantierit, grafikun e përgjithshëm të punimeve dhe planin e veprimit për ndërtimin e objektit sipas projektit, në përputhje me afatet dhe kushtet e kontratës;

ë) aktin e miratimit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, miratuar nga organi kompetent;

f) ndryshimet në projekt (nëse ka) dhe miratimin e tyre, si dhe dokumentacionin ku pasqyrohen të gjitha problemet e verifikuara, të miratuara dhe të firmosura nga ai;

g) certifikatën profesionale (licencat) të pjesëmarrësve në procesin e ndërtimit;

gj) njoftimin për fillimin e punimeve, sipas shtojcës VI, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

h) procesverbalin mbi fillimin e punimeve në objekt, sipas shtojcës X, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

i) aktin e piktimit të objektit, sipas shtojcës IX, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

j) aktkontrollin e kuotës + 0.00, sipas shtojcës II, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

k) aktet e miratimit në fushën e trashëgimisë kulturore, arkeologjike apo zonat e mbrojtura mjedisore, sipas legjislacionit sektorial në fuqi;

l) librezën e masave, ku pasqyrohen vëllimet metrike gradualisht me zhvillimin e punimeve, sipas shtojcës IV, që i bashkëlidhet këtij vendimi, e cila është dokumentacioni bazë për verifikimin e



saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i zhvilluesit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit;

ll) situacionet mujore pjesore dhe progresive, të hartuara mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit. Ato firmosen nga drejtuesi teknik i objektit, mbikëqyrësi i punimeve dhe përfaqësuesi ligjor i zhvilluesit, sipas shtojcës XII, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

m) librin e kantierit;

n) ditarin e objektit, sipas shtojcës V, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

nj) pasqyrën e realizimit të punimeve, sipas shtojcës XI, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

o) procesverbalet e punimeve të maskuara, sipas shtojcave VII dhe VIII, që i bashkëlidhen këtij vendimi;

p) provat dhe certifikatat e cilësisë së materialeve të përdorura në objekt;

q) aktin e kontrollit të përfundimit të karabinasë së objektit;

r) deklaratën teknike të zbatuesit të punimeve, sipas shtojcës III, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

rr) aktin e kolaudimit të fazës së karabinasë;

s) dokumentacionin për masat e sigurimit teknik dhe pajisjen me mjete mbrojtëse përkatëse;

sh) aktet e inspektimit të kryera gjatë zbatimit të punimeve, sipas shtojcës II, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

t) dokumentin e vlerësimit të rrezikut, që hartohet për një kantier të veçantë, sipas vendimit nr. 312, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier””, i quajtur Plani i sigurisë dhe koordinimit (PSK);

th) siguracionin e punonjësve, të cilët punojnë në objekt;

u) siguracionin për dëmtim kundrejt palëve të treta në infrastrukturën publike;

v) policën e sigurimit të përgjegjësive profesionale;

x) dokumentacionin fotografik apo video-regjistrimin për çastet më të rëndësishme të

zbatimit të punimeve, veçanërisht për ato që bëhen të padukshme, punimet e maskuara;

xh) projektin e zbatuar;

y) projektin për mirëmbajtjen e objektit, i cili të përmbajë edhe afatet e kontrollit periodik në intervale kohore të përcaktuara të gjendjes së të gjitha sistemeve përbërëse, sipas disiplinave përkatëse të zbatimit të punimeve;

z) certifikimi i montimit të ashensorëve dhe inspektimi final;

zh) raportimet 45-ditore të bëra pranë Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit/ Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe autoritetit të lëshimit të lejes së ndërtimit.

Neni 42

1. Mbikëqyrësi i punimeve për proceset e ndërtimit të objekteve të banimit, social-kulturore dhe ekonomike mban aktet e kontrollit, sipas këtyre fazave:

a) ngritja e kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues;

b) piketimi i strukturës;

c) përfundimi i themeleve dhe kuota + 0.00;

ç) përfundimi i karabinasë për të gjithë objektin;

d) përfundimi i fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re, përfshirë instalimet elektrike, të ngrohjes, ftohjes, hidraulike, të komunikimit elektronik;

dh) përfundimi i sistemimit të jashtëm në planin e vendosjes së strukturës së re, përfshirë vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturën publike ekzistuese.

2. Aktet e kontrollit janë pjesë e dokumentacionit që mbahet në objekt dhe një kopje depozitohet pranë njësisë vendore, të shoqëruara me një deklaratë përgjegjësie, të plotësuar nga subjekti/personi fizik, juridik që i ka hartuar, sipas fazave të grafikut të punimeve dhe afatit të lejes.

Neni 43

1. Mbikëqyrësi i punimeve, pas verifikimeve të përcaktuara në nenin 8, të këtij vendimi, harton këto dokumentacione:

a) aktin e dorëzimit të sheshit të ndërtimit që ia dorën zbatuesit të punimeve;

b) aktin e dorëzimit nga zbatuesi i punimeve të dokumentacionit, teknik dhe administrativ, si



licenca, autorizime e leje të marra për ndërtimin e objektit;

c) shkresën, me atë të së cilës njofton autoritetin vendor dhe Inspektoratin Kombëtar të Mbikëqyrjes së Territorit/Inspektoratin Vendor të Mbikëqyrjes së Territorit për fillimin e punimeve.

Neni 44

1. Mbikëqyrësi i punimeve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga njoftimi me shkrim nga zbatuesi i punimeve për përfundimin e punimeve, nëse nuk i vihet në dispozicion, i kërkon zbatuesit të punimeve dokumentacionin, si më poshtë vijon:

a) kontratën dhe aktet që lidhen me të;

b) regjistrimin e kontabilitetit;

c) procesverbalet e fillimit, të ndërprerjes ose të zgjatjes dhe të përfundimit të punimeve;

ç) certifikatat e cilësisë së provave të materialeve të përdorura gjatë procesit të ndërtimit, të lëshuara nga laboratorët e akredituar për këtë qëllim;

d) për materiale të importuara, certifikatën e cilësisë nga një laborator i akredituar nga vendet e Bashkimit Evropian;

dh) deklaratën që vërteton se objekti është zbatuar në përputhje me projektin e zbatimit pa shmangie në drejtimet funksionale dhe statike, si dhe në përputhje me kushtet teknike në fuqi, sipas shtojcës III, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

e) deklaratën që vërteton se objekti është në përputhje me lejen e ndërtimit dhe ndryshimet e miratuara, nëse ka pasur.

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 45

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore, Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, autoritetet e zhvillimit të territorit, çdo autoritet publik që mbikëqyr veprimtarinë e ndërtimit.

Neni 46

Në udhëzimin nr. 3, datë 15.2.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve në ndërtim”, të ndryshuar, shfuqizohet kreu I “Mbikëqyrja e punimeve të ndërtimit”.

Neni 47

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



SHTOJCA I

AKT DORËZIMI SHESHIT TË NDËRTIMIT

I mbajtur sot më dt. _____ mbi dorëzimin e sheshit të ndërtimit me adresë:
“ _____ ” në prezencë të:

Zhvilluesit

(_____) përfaqësuar nga _____
Sektori, Nënkontraktori, Dega, etj _____ përfaqësuar nga _____

Shoqëria e zbatimit të punimeve _____ sh.p.k

1. Drejtuesi ligjor _____
2. Drejtuesi teknik _____
3. Drejtuesi i kantierit _____

Mbikëqyrësi i Punimeve _____ sh.p.k

1. Drejtuesi ligjor _____
2. Inxhinieri zbatues _____

Nga verifikimi në vend u konstatua se sheshi i ndërtimit është i lirë dhe shoqëria e zbatimit të punimeve _____ sh.p.k. merr në dorëzim sheshin e ndërtimit për realizimin e punimeve sipas kontratës Nr. _____ dt. _____ të lidhur midis zhvilluesit dhe zbatuesit të punimeve për objektin _____.

Sheshi kufizohet:

Nga Jugu _____
Nga Veriu _____
Nga Lindja _____
Nga Perëndimi _____

Akt dorëzimi mbahet në tre kopje, si më poshtë vijon:

- Një kopje për zhvilluesin _____
- Një kopje për mbikëqyrësin e punimeve shoqëria _____ sh.p.k.
- Një kopje për sipërmarrësin shoqëria _____ sh.p.k.

MBIKËQYRESI I PUNIMEVE

ZBATUESI I PUNIMEVE

ZHVILLUESI



SHTOJCA II

AKT KONTROLLI

NR. _____, Datë _____

Emri i subjektit të mbikëqyrur ” _____ ”

Vendodhja: _____

Data/ora: ____ / ____ / ____ ; _____

Progresi i punës _____

Pjesëmarrësit :

Mbikëqyrësi _____

Drejtuesi teknik _____

Drejtuesi i punimeve _____

(të

tjerë) _____

Përshkrimi i situatës	Zbatuar nga	Data e afatit të fundit

Konstatimet:

P.sh. Puna është në fazën fillestare. - Kontraktuesi po punon për pastrimin e sheshit të ndërtimit. Në sheshin e ndërtimit janë hedhur materiale të ndryshme, të cilat do të ngarkohen dhe transportohen në vendin e caktuar për depozitim. - Po kryhet instruktimi i punonjësve për sigurinë në objekt në mënyrë që të parandalohet dëmtimi e punonjësve gjatë procesit të ndërtimit. - Kontrolli i paisjeve dhe makinerive që do të përdoren në procesin e ndërtimit për sigurinë në kantier në përputhshmëri me legjislacionin për sigurinë në vendin e punës. - Azhornimi me pikat e furnizimit me energji, ujë etj. - Përcaktimi i datës së kontrollit të radhës.		
---	--	--

ZBATUESI I PUNIMEVE: “ _____ ”

OBJEKTI: “ _____ ”



SHTOJCA III
DEKLARATË TEKNIKE E ZHVILLUESIT

Në zbatim të nenit 11, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar nënshkruesit e këtij dokumenti:

- z. _____ drejtues ligjor i firmës me licencë nr. _____,
z. _____ drejtues teknik,
z. _____ përfaqësues i zbatuesit të punimeve.

Deklarojmë sa më poshtë:

1. Objekti " _____ ", që ndodhet në qarkun e _____, në bashkinë/komunën e _____ me adresë _____ është ndërtuar sipas projektit të zbatimit të miratuar, kushteve teknike dhe standarteve në fuqi, dhe specifikimeve teknike të evidentuara në kontratën e sipërmarrjes nr. _____, datë ____/____/____.
2. Gjatë zbatimit të objektit janë respektuar kondicionet urbane të përcaktuara në lejen e zhvillimit nr. _____, datë ____/____/____ dhe është kryer sistemimi i territorit sipas PPV/PDV të miratuar.
3. Mbështetur në ecurinë e punimeve, kontrollin e cilësisë së materialeve, produkteve dhe punimeve të ndërtimit, dokumentacionin e hartuar nga sipërmarrësi për punimet e maskuara, projekti i miratuar në organet përkatëse nr. _____, datë ____/____/____ është zbatuar plotësisht, pa shtesa dhe pakësime dhe nuk ka shmangie në drejtimin funksional, të qëndrueshmërisë dhe destinacionit.
 - Objekti në formë, dimension, sipërfaqe e vëllim është zbatuar sipas projektit të miratuar dhe ndryshimeve të miratuara nga projektuesi, investitori dhe organet përkatëse.
 - Vëllimet dhe klasat, sipas llojeve të punimeve në objekt (gërmime, beton, mure, etj) janë të njëjta me ato të specifikuara në kushtet e kontratës dhe ndryshimeve të miratuara nga projektuesi, zhvilluesi dhe organet përkatëse.
 - Zërat e punimeve janë realizuar sipas preventivit të miratuar dhe ndryshimeve të miratuara nga projektuesi, zhvilluesi dhe organet përkatëse.
4. Strukturat bazë/mbajtëse (trupi i rrugës, skeleti mbajtës, muratuara mbajtëse, etj.) janë realizuar sipas kërkesave, materialeve e produkteve të parashikuara në projekt.
 - Disa prej tyre mund të jenë: i) _____, ii) _____, iii) _____, iv) _____, v) _____, vi) _____, vii) _____.
 - Tulla/guri, janë furnizuar sipas standardit nr. _____, datë ____/____/____.
 - Skeleti metalik sipas rregullave teknike dhe standarteve në fuqi të zbatimit nr. _____, datë ____/____/____.
 - Hekuri/betoni janë furnizuar sipas rregullave teknike dhe standarteve në fuqi nr. _____, datë ____/____/____.
 - Materiali mbushës / veshës i rrugës është sipas rregullave teknike dhe standarteve në fuqi nr. _____, datë ____/____/____.
 - Muratura mbajtëse është zbatuar sipas rregullave teknike dhe standarteve në fuqi nr. _____, datë ____/____/____.
 - Struktura b/arme monolite është realizuar sipas rregullave teknike dhe standarteve në fuqi nr. _____, datë ____/____/____.
 - Instalimet e furnizimit me ujë janë zbatuar sipas rregullave teknike dhe standardeve në fuqi nr. _____, datë ____/____/____.



- Rrjeti i kanalizimit të ujrave të bardha/ të zeza është realizuar sipas rregullave teknike dhe standardeve në fuqi nr. _____, datë ____/____/____.
- Rrjeti i furnizimit me energji elektrike dhe ndriçimit janë zbatuar sipas rregullave teknike dhe standardeve në fuqi nr. _____, datë ____/____/____.
- Etj.

(Zgjidhen ato përcaktime që janë më të domosdoshme sipas llojit të objektit.)

5. Sistemi i infrastrukturës është provuar pa dhe me ngarkesë dhe rezulton i ndërtuar në përputhje me kërkesat e projektit dhe me rregullave teknike e standardet në fuqi.
6. Izolimi (termik, akustik, hidroizolues etj.) janë zbatuar sipas projektit, si dhe janë provuar dhe rezultojnë pa defekt.

Zbatuesi I punimeve mban përgjegjësi për sa deklarohe më lart në rast se në objekt shfaqen defekte, gjatë kohës dhe kushteve të përcaktuara në aktet ligjore e nën ligjore në fuqi, të cilat nuk janë si pasojë e administrimit dhe/apo shfrytëzimit, kur këto të fundit janë kryer brënda kushteve të parashikuara në projekt, në kontratën e sipërmarrjes dhe kushteve/rregullave/standardeve teknike në fuqi.

Kjo deklaratë hartohet në tre kopje, një kopje mbahet nga zbatuesi i punimeve në arkivin teknik në dosjen e objektit, një kopje i dërgohet mbikëqyrësit të punimeve I cili e bënë pjesë të dosjes për kolaudim dhe një kopje si pjesë e dokumentacionit përkatës që depozitohet në autoritetin vendor të zhvillimit të territorit.

Drejtuesi Teknik i Firmës

Drejtuesi Teknik i Objektit

Për zbatuesin e punimeve “ _____ ”

Drejtuesi Ligjor _____



SHTOJCA IV
LIBREZE MASASH

Objekti :

Zhvilluesi :
“ _____ ”shpk

Mbikëqyrësi i punimeve :
_____ shpk

Zëri sipas preventivit :

Skica	Nr	Progresivi (Piketa)	Zëri i Punimeve	Njësia	Faktorët				Shuma
					Gjatësi	Gjerësi	Lartësi	Sip. Mesa tare	
SHUMA TOTALE									

Zbatuesi i
punimeveMbikëqyrësi i
punimeve

Përfaqësuesi i zhvilluesit

Ing _____
_____Ing _____
_____**SHTOJCA V
DITARI I OBJEKTIT****Objekti :** _____

Zbatuesi i punimeve: “ _____ ” sh.p.k.

Mbikëqyrësi: “ _____ ” sh.p.k.

MOTI				TEMPERATURAT	
me diell	me diell dhe vranësira	i vrenjtur	me shi	minimale	maximale
					

**PUNOJNË NË OBJEKT****I) Personeli Teknik**

1) Përgjegjës

2) Inxhinier ndërtimi

3) Teknik ndërtimi

4) Inxhinier topograf

5) Arkitekt

II) Specialistë dhe puntorë1.
Specialistë

2. Puntorë

3.
Manovratorë

4. Roje

5.

6.

7.

8.

MAKINERI DHE PAJISJE

1.

5.

9.

2.

6.

10.

3.

7.

11.

4.

8.

12.

SOT U KRYEN KËTO PROCESE PUNE

1.

2.

3

4.



U MBAJTËN KËTO DOKUMENTACIONE TEKNIKE

1.

2.

3.

PËR ZBATUESIN E PUNIMEVE

Ing. _____

SHËNIME TË MBIKËQYRËSIT

PËR MBIKËQYRËSIN: “ _____ ” sh.p.k.

Ing. _____

SHËNIME TË PERFAQËSUESIT TË ZHVILLUESIT



SHTOJCA VI
NJOFTIM PËR FILLIM PUNIMESH

Nr _____ prot

Datë _____

Për: _____ Dega _____

Nga: “ _____ ” sh.p.k

Ju njoftojmë se kemi filluar punimet në objektin: _____

në bazë të kontratës nr. _____ datë _____ lidhur me zhvilluesin _____.

Të dhënat kryesore të kësaj kontrate janë si më poshtë:

Objekti: “ _____ ”.**Vlera e objektit:** _____ lek**Zhvilluesi:** _____**Zbatuesi i punimeve (kontraktori):** _____ sh.p.k.**Zbatuesi i punimeve (nënkontraktori)** _____
sh.p.k.**Projektuesi:** _____ sh.p.k.**Mbikëqyrësi i punimeve:** _____ sh.p.k.**Leja e zhvillimit:** _____**Leja e ndërtimit:** _____**Data e fillimit të punimeve:** _____**Data e përfundimit të punimeve:** _____

Bashkëngjitur po ju dërgojmë dokumentacionin përkatës të këtij objekti.

Zbatuesi i punimeve “ _____ ”**Përfaqësuesi** _____

SHTOJCA VII
PROCESVERBAL
PËR PUNIME TË MASKUAR NË STRUKTURAT BETON-ARME

NR _____, Datë _____

PUNIME BETONI DHE KALLËPE**SIPËRMARRËSI:** “ _____ ”**OBJEKTI:** “ _____ ”

Emërtimi i elementit:

Sot më datë _____, u kontrollua gjendja e punimeve të betonit dhe beton armesë dhe rezultoi si më poshtë:

- Struktura u betonua prej datës _____ deri në _____ dhe u përdorë beton i klasës _____ i përgatitur nga shoqëria prodhuese e betonit _____



Ngjeshja u krye me vibrator sipas kërkesave teknike.

2. Gjatë procesit të betonimit u konstatua ecuria e mëposhtëme dhe u morën masat (shënuar përbri)

2.1 _____.

2.2 _____.

2.3 _____.

2.4 _____.

3. Ndërprerjet e procesit të betonimit u bënë në pozicionet _____ dhe rifillimi i këtij procesi u bë sipas rregullave teknike dhe standarteve në fuqi të zbatimit nr. _____, datë ____/____/____.

4. Trajtimi dhe mbrojtja e betonit në strukturë _____.

5. Heqja e kallëpeve dhe skelave mbajtëse të tyre filloi më datën _____ dhe përfundoi më datën _____.

6. Gjatë kontrollit të strukturës mbas çlirimit të pykave rezultoi:

7. Zgavrat, plasaritjet dhe hekurat e xhveshura u riparuan në përputhje me rregullave teknike dhe standarteve në fuqi të zbatimit nr. _____, datë ____/____/____.

8. Nga kontrolli i kuotave, akseve dhe përmasave të strukturës rezultoi se ato janë brenda largimeve të lejuara sipas rregullave teknike dhe standarteve në fuqi nr. _____, datë ____/____/____, me përjashtim të _____

Për të sjellë strukturën në kushtet e projektit janë kryer punimet e mëposhtme:

Në mbështetje të rezultateve të mësipërm, struktura merret në dorëzim dhe autorizohet vazhdimi i punimeve _____

DREJTUESI TEKNIK I PUNIMEVE

DREJTUESI TEKNIK (ING. I OBJEKTIT)

MBIKËQYRËSI

**SHTOJCA VIII
PROCESVERBAL****PËR PUNIME TË MASKUAR NË STRUKTURAT BETON-ARME**

NR. _____, Datë _____

PUNIME HEKURI DHE ARMATUR

ZBATUESI I PUNIMEVE: “ _____ ”

OBJEKTI: “ _____ ”

Emërtimi i elementit:

Sot më datë _____, u kontrollua gjendja e kallëpeve, skelës mbajtëse të tyre, gjendja e armaturës dhe detajeve, dhe rezultoi si më poshtë:

1. Kuota dhe përmasat e kallëpeve u gjetën brenda distancës së lejuar sipas rregullave teknike dhe standardeve në fuqi nr. _____, datë ____/____/____. Kallëpet dhe skelat mbajtëse të tyre janë mbërthyer dhe shtrënguara me _____.
2. Vrimat dhe detajet metalike janë vendosur në pozicionet e projektit, brenda tolerancave, sipas rregullave teknike dhe standardeve në fuqi nr. _____, datë ____/____/____.
3. Hekuri i përdorur është i klasës _____, sipas projektit dhe analizat e provave të kryera sipas rregullave teknike dhe standardeve në fuqi nr. _____, datë ____/____/____, dhanë këto rezultate _____.
4. Për mungesë të diametrave janë bërë ndryshime nga projekti në pozicionet e mëposhtme
_____.
5. Sipas kërkesës së projektit, provat e saldimit të shufrave të zgjatura me saldim, pozicioni _____ dhanë këto rezultate _____.
6. Hekurat janë vendosur në pozicionin e projektit.
7. Etj. (të ndryshme).

Në mbështetje të rezultateve të mësipërme, lejojmë që sot të fillojë betonimi i strukturës.

PËRGJEGJËSI I HEKURKTHYESVE

REJTUESI TEKNIK I PUNIMEVE

PËRGJEGJËSI I KARPENTERISË DREJTUESI TEKNIK (ING. I OBJEKTIT)

MBIKËQYRËSI



SHTOJVA IX

PROCESVERBAL MBI AKT PIKETIMIN

NR. _____, Datë _____

OBJEKTI: “_____”

I mbajtur sot më dt. _____ mbi aktin e piketimit në objektin “_____”
në prezencë të :

1. Mbikëqyrësi i punimeve “_____” sh.p.k. përfaqësuar nga ing. _____.
2. Zbatuesi i punimeve “_____” sh.p.k. përfaqësuar nga Drejtuesi

Teknik ing. _____.

Pas verifikimit në vend u konstatua se objekti është piketuar sipas projektit të miratuar.

Lejohet vazhdimi i punimeve sipas grafikut dhe projektit.

Procesverbali mbahet në 3 (tre) kopje.

Një kopje për zhvilluesit: “_____” sh.p.k.

Një kopje për Mbikëqyrësin e punimeve: “_____” sh.p.k.

Një kopje për zbatuesit të punimeve e punimeve: “_____” sh.p.k.

ZBATUESI I PUNIMEVE

MBIKËQYRËSI

“_____”sh.p.k.

Ing. _____



SHTOJCA X

PROCESVERBAL

MBI FILLIMIN E PUNIMEVE

NR. _____, Datë _____

OBJEKTI: “_____”

I mbajtur sot më dt. _____ mbi fillimin e punimeve në objektin
 “_____” në prezencë të:

1. **MBIKËQYRËSI I PUNIMEVE** “_____” sh.p.k, përfaqësuar nga
ing. _____.
2. **ZBATUESI I PUNIMEVE** “_____” sh.p.k përfaqësuar nga
drejtuesi teknik _____

Zbatuesi i punimeve “_____” sh.p.k. depozitoi pranë mbikëqyrësit të
 punimeve kopje të kontratës, preventivin, grafikun e punimeve, listën e makinerive dhe të
 stafit.

Zbatuesi i punimeve “_____” sh.p.k., ka caktuar në objekt:

Stafin e përbërë nga:

1. Drejtues teknik _____
2. Drejtues punimesh _____
3. Ing.topograf _____
4. Teknik _____
5. Punëtorë _____

Makineritë dhe pajisjet:

1 _____	copë _____	6 _____	copë _____
2 _____	copë _____	7 _____	copë _____
3 _____	copë _____	8 _____	copë _____
4 _____	copë _____	9 _____	copë _____
5 _____	copë _____	10 _____	copë _____

Data e fillimit të punimeve është ____/____/____
 ZBATUESI I PUNIMEVE “_____” sh.p.k. të hapë Ditarin e
 objektit, të hartojë librezën e masave dhe të mbajë procesverbalet përkatëse me realizimin e
 proceseve të punës.



Fillimi i Punimeve të nisë nga piketimi i objektit. Të përcaktohen dhe të shënohen në terren piketat sipas projektit dhe pasi të kontrollohen dhe të miratohen nga mbikëqyrësi i punimeve dhe inxhinieri gjeodet të hartohet procesverbali përkatës, ku të jenë të pasqyruara matjet faktike dhe në rast se nuk ka ndryshime nga projekti, të vazhdohet me punimet e tjera sipas grafikut të punimeve.

Procesverbali mbahet në tre kopje si më poshtë vijon :

- Për zhvilluesin _____
- Për mbikëqyrësin e punimeve, “ _____ ” sh.p.k.
- Për zbatuesin e punimeve, “ _____ ”sh.p.k.

MBIKËQYRËSI I PUNIMEVE

“ _____ ” sh.p.k.

ZBATUESI I PUNIMEVE

“ _____ ” sh.p.k.

ZHVILLUESI



SHTOJCA XI
PASQYRA E REALIZIMIT TË PUNIMEVE

Datë _____

OBJEKTI: “_____”

ZBATUESI I PUNIMEVE: “_____” sh.p.k.

Nr.	Emërtimi i punimeve	Njësia	Preventivi			Sasia e realizuar në muaj/javë						Gjithsej deri me	
			Sasia	Çmimi	Vlera	I	II	III	IV	V	VI	Në sasi	Në %
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14

DREJTUESI TEKNIK

ZBATUESI I PUNIMEVE

MBIKËQYRËSI

ZHVILLUESI



SHTOJCA XII
SITUACION PUNIMESH
Pjesore/Progresive

OBJEKTI: “_____”

ZBATUESI I PUNIMEVE: “_____” sh.p.k.

Datë: ____/____/____

Nr.

**Nr. i
analizës**

**Emërtimi i
punimeve të
kryera**

Njesia

**Sasia e
punimeve
të kryera**

Çmimi Vlefë

Shuma e analizave
Fondi rezervë deri në 5%
(vendoset në situacionin
përfundimtar në % e përdorur)

Shuma (Analiza+fondi rezervë)

TVSH
Pajisje
Totali

DREJTUESI TEKNIK

MBIKËQYRESI

ZHVILLUESI (përfaqësuesi ligjor)

**VENDIM****Nr. 613, datë 22.9.2022**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË
HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM, PËR FINANCIMIN E
PROJEKTIT PËR ZHVILLIMIN E
INTEGRUAR URBAN DHE TURIZMIN,
RATIFIKUAR ME LIGJIN NR. 19/2017**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për financimin e projektit për zhvillimin e integruar urban dhe turizmin, ratifikuar me ligjin nr. 19/2017, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku**

BANKABOTËRORE

ZYRA E GRUPIT TË
BANKËS BOTËROREIBRD – IDA/GRUPI I
BANKËS BOTËRORERruga “Ibrahim Rugova”,
nr. 34
Tiranë, Shqipëri**Emanuel Salinas**

Menaxher për Shqipërinë

8 shkurt 2022

Nr. prot. 04/22

Shkëlqesisë së Saj, Delina Ibrahimaj

Ministre

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Tiranë, Shqipëri

E nderuar znj. Ministre,

Shqipëria: Projekti për Zhvillimin e Integruar

Urban dhe Turizmin

Amendim i Marrëveshjes së Huas nr. 8656 – AL

Ju lutem gjeni bashkëlidhur për siglim nga ana juaj 2 (dy) kopje origjinale të Amendimit të Huas nr. 8656 – AL për Projektin e Zhvillimit të Integruar Urban dhe Turizmit.

Ju lutem ktheni tek Zyra e Bankës Botërore në Tiranë 1 (një) kopje të nënshkruar të Amendimit.

Me respekt,

Emanuel Salinas

Menaxher i Bankës Botërore për Shqipërinë

Evropën dhe Rajonin e Azisë Qendrore

Tel: + 355 42280 650/51 Faks: +355 42240

590

BANKA BOTËROREIBRD – IDA/GRUPI I BANKËS
BOTËRORE

8 shkurt 2022

Shkëlqesisë së Saj, Delina Ibrahimaj
Ministre e Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Tiranë,
Republika e Shqipërisë

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË:
PROJEKTI PËR ZHVILLIMIN E
INTEGRUAR URBAN DHE TURIZMIN
(Huaja nr. 8656 – AL)
Amendim i Marrëveshjes së Huas**

Shkëlqesi:

I referohemi Marrëveshjes së Huas, datë 13 dhjetor 2016, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka) (Marrëveshja e Huas) për Projektin e lartpërmendur për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin (Projekti). Gjithashtu, i referohemi shkresës tuaj, datë 14 maj 2020, dhe bisedimeve pasuese ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit për amendimin e Marrëveshjes së Huas për reflektimin e ndryshimeve në Projektin e përfshirë në Marrëveshjen e Huas ndërmjet Bankës dhe Huamarrësit për Financim Shtesë të Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin (Marrëveshja e Financimit Shtesë).

Banka dhe Huamarrësi bien dakord që Marrëveshja e Huas të amendohet, si më poshtë:



1. a) Të gjitha referencat “Ministria e Zhvillimit Urban” ose “MZHU” zëvendësohen me referencat “Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë” ose “MIE”; b) të gjitha referencat “Ministria e Financave” ose “MF” zëvendësohen me referencat “Ministria e Financave dhe Ekonomisë” ose “MFE”; dhe c) të gjitha referencat “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes” ose “MZHE/TTS”, dhe “Ministria e Mjedisit” ose “MM” bashkohen dhe zëvendësohen me referencat “Ministria e Turizmit dhe Mjedisit” ose “MTM”.

2. Skeduli 1 ndryshon dhe lexohet në tërësinë e tij si siç përcaktohet në shtojcën e kësaj shkrese amendimi.

3. Seksioni 1.A, i skedulit 2 ndryshon dhe lexohet në tërësinë e tij si më poshtë:

“A. Masat institucionale

1. Njësia për Koordinimin e Projektit dhe MIE

a) Huamarrësi, nëpërmjet MIE-s:

i. mban gjatë të gjithë kohës së zbatimit të Projektit NJKP në e tij, stafi kryesor i së cilës ka në përbërje një urbanist, një specialist të turizmit dhe një arkitekt, ku të gjithë kanë kualifikime dhe përvojë, dhe sipas termave të referencës të pranueshme për Bankën; dhe

ii. garanton që NJKP-ja e tij të kryejë mbikëqyrjen e Projektit dhe bashkërendimin e kontributeve teknike të Bashkive të Përzgjedhura; dhe

iii. bashkërendon me KDP-në mbi përgjegjësitë e KDP-së, në lidhje me zgjidhjen e problemeve që dalin gjatë zbatimit të Projektit, si dhe lehtësimin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet agjencive kryesore qeveritare të përfshira në zbatimin e Projektit me bashkitë e përzgjedhura;

b) Huamarrësi, nëpërmjet MIE-s, nxit Entin Zbatues të Projektit që:

i. gjatë të gjithë kohës së zbatimit të Projektit të mbajë stafin e tij kryesor që ka në përbërje një menaxher të Projektit, një arkitekt, një inxhinier, një specialist për administrimin financiar, një specialist prokurimi, një specialist turizmi, një specialist për angazhimin qytetar, një specialist mjedisi dhe një specialist për problemet sociale, ku të gjithë kanë kualifikime, përvojë, përgjegjësi dhe iniciativë të pranueshme për Bankën; dhe

ii. të realizojë zbatimin e Projektit, duke përfshirë administrimin financiar, prokurimin dhe menaxhimin e kontratës.

2. Komiteti Drejtues i Projektit

Huamarrësi:

a) mban, gjatë të gjithë kohës së zbatimit të Projektit, një Komitet Drejtues të Projektit (KDP) që ka në përbërje përfaqësues nga MIE, MTM-ja, MK-ja, MFE-ja, Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes, Enti Zbatues i Projektit dhe bashkitë e përzgjedhura; dhe çdo përfaqësues tjetër të parashikuar në Manualin e Operimit të Projektit; dhe

b) garanton që KDP-ja: i. të mbledhet të paktën çdo gjashtë (6) muaj; ii. të mbështesë MIE-n për të mbikëqyrur në mënyrë tërësore menaxhimin e Projektit, përfshirë, ndër të tjera, mbështetjen për bashkërendimin e palëve të interesuara dhe zgjidhjen e çështjeve ose problemeve të rëndësishme ndërrajonale/sectoriale të shkaktuara gjatë zbatimit të Projektit.

4. Seksioni B.1 (A) i skedulit 2 ndryshon dhe lexohet në tërësinë e tij, si më poshtë:

a) Jo më vonë se 90 ditë pas datës së hyrjes në fuqi, Huamarrësi, nëpërmjet MIE-s, nxit Entin Zbatues të Projektit që të përditësojë, miratojë, dhe më pas ta realizojë dhe zbatojë Projektin në përputhje me dispozitat e një manuali (Manuali Operacional i Projektit) në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën, i cili përmban: i. një përshkrim të detajuar të Projektit; ii. listën e zonave të përzgjedhura turistike, zonat e përzgjedhura dhe bashkitë e përzgjedhura; iii. procedurat e zbatimit të Projektit; iv. masat e detajuara institucionale, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe ligjet dhe rregulloret e zbatueshme, dhe duke përfshirë, ndër të tjera, grafikët e veprimeve që kërkohet të kryhen në kuadër të Projektit, stafin, aspektet fiduciare, aspektet teknike dhe operative dhe procedurat për zbatimin e Projektit; v. procedurat e administrimit financiar (buxhetimi, kontabiliteti dhe kontrolli i brendshëm, disbursimi dhe qarkullimi i fondeve, raportimi financiar, raportet vjetore, procedurat për planifikimin e auditimeve të brendshme dhe të jashtme, si dhe përfshirë planin e posaçëm kontabël të Projektit); vi. Marrëveshjen model të Bashkëpunimit; vii. procedurat e prokurimit; viii. KMMS-në dhe KPR-në; ix. masat e vlerësimit dhe monitorimit të Projektit; x. rregullat e monitorimit të projektit; dhe



xi. dhe masat e tjera fiduciare dhe administrative, manual ky që mund të ndryshohet herë pas here me miratimin e Bankës.”.

5. Seksioni II, i skedulit 2 ndryshon dhe lexohet në tërësinë e tij, si më poshtë:

“Huamarrësi, nëpërmjet MIE-s, i dorëzon Bankës çdo raport të Projektit jo më vonë se një muaj pas mbarimit të çdo semestri kalendarik që mbulon semestrin kalendarik.”.

6. Seksioni III i skedulit ndryshon për t’u lexuar në tërësinë e tij, si më poshtë:

“Seksioni III. Prokurimi

Rregulloret e Prokurimit

Të gjitha mallrat, shërbimet e jokonsulencës dhe shërbimet e konsulencës që kërkohen për Projektin dhe që duhen financuar me të ardhurat nga Huaja, dhe për të cilat procesi i prokurimit fillon në apo pas datës së nënshkrimit, prokurohen në përputhje me kërkesat që parashikohen apo përmenden në rregulloret e prokurimit dhe dispozitat e Planit të Prokurimit.

Udhëzuesi për Prokurimin dhe udhëzuesi për Konsulentin

A. Të përgjithshme

1. Mallra, punime dhe shërbime jokonsulencë. Të gjitha mallrat, punimet dhe shërbimet e jokonsulencës që kërkohen për Projektin dhe që duhen financuar me të ardhurat nga Huaja dhe për të cilat procesi i prokurimit fillon në apo pas datës së nënshkrimit, prokurohen në përputhje me kërkesat që parashikohen apo përmenden në seksionin I të Udhëzuesit për Prokurimin, si dhe me dispozitat e këtij seksioni.

2. Shërbimet e konsulentëve. Të gjitha shërbimet e konsulentëve që kërkohen për Projektin dhe që duhen financuar me të ardhurat nga Huaja, dhe për të cilat procesi i prokurimit fillon në apo pas datës së nënshkrimit, prokurohen në përputhje me kërkesat që parashikohen apo përmenden në seksionet I dhe IV, të Udhëzuesit për Konsulentët, si dhe me dispozitat e këtij seksioni.

3. Përkufizime. Termat e shkruara me germa kapitale që përdoren më poshtë në këtë seksion për të dhënë një përshkrim të metodave të posaçme të prokurimit apo metodave të Bankës për shqyrtimin e marrëveshjeve të posaçme, i referohen metodës përkatëse, një përshkrim i së cilës jepet në seksionet II dhe III, të Udhëzuesit për Prokurimin, apo në

seksionet II, III, IV dhe V ,të Udhëzuesit për Konsulentët, sipas rastit.

B. Metodatat e posaçme të prokurimit të mallrave, punimeve dhe shërbimeve të jokonsulencës

1. Oferta ndërkombëtare për konkurrim.

Përveç kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, mallrat, punimet dhe shërbimet e jokonsulencës prokurohen sipas kontratave fituese që jepen mbi bazën e ofertës ndërkombëtare për konkurrim.

2. Metoda të tjera për prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve të jokonsulencës. Metodatat e mëposhtme, përveç ofertës ndërkombëtare për konkurrim, mund të përdoren për prokurimin e mallrave, punimeve dhe shërbimeve të jokonsulencës për ato kontrata që përcaktohen në Planin e Prokurimit: a) oferta kombëtare për konkurrim sipas dispozitave shtesë të paragrafit 3 të këtij seksioni; b) blerje; dhe c) kontraktimi i drejtpërdrejtë.

3. Ndryshime të procedurave të huamarrësit, në lidhje me ofertën kombëtare për konkurrim. Procedurat, në lidhje me Ofertën Kombëtare për Konkurrim (OKK), bazohen në procedura të hapura tenderimi, siç është përcaktuar në ligjin shqiptar në fuqi për prokurimin, me kusht, sidoqoftë, që një procedurë e tillë t’u nënshtrohet dispozitave të seksionit I dhe paragrafëve 3.3 dhe 3.4, të Udhëzuesit për Prokurimin dhe dispozitave shtesë të mëposhtme:

a) procedurat “e hapura të tenderimit”, siç është përcaktuar në LPP-në e Shqipërisë, zbatohen për të gjitha marrëveshjet e financuara nga Banka;

b) ofertuesit e huaj nuk përjashtohen nga paraqitja e ofertave dhe nuk u jepet asnjë preferencë e ndonjë lloji ofertuesve vendas në procesin e tenderit. Në Shqipëri lejohet që ndërmarrjet shtetërore të paraqesin oferta vetëm në rast se janë të pavarura nga pikëpamja ligjore dhe financiare, dhe veprojnë në bazë të së drejtës tregtare të Huamarrësit. Regjistrimi nuk përdoret për të vlerësuar kualifikimet e ofertuesve;

c) ofertat hapen në mënyrë publike, në një vend, menjëherë pas mbarimit të afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave, në prani të përfaqësuesve të cilët vendosin të marrin pjesë;

d) entet prokuruese përdorin dokumente model të tenderit, siç janë miratuar nga Banka;



e) në rast të çmimeve më të larta të ofertave, krahasuar me vlerësimin zyrtar, asnjë ofertë nuk refuzohet pa marrëveshje paraprake të Bankës;

f) për paraqitjen e ofertave përdoret procedura me një zarf të vetëm;

g) paskualifikimi bëhet vetëm për ofertuesin me vlerësimin më të ulët; asnjë ofertë nuk refuzohet në kohën e hapjes së ofertave për arsye kualifikimi;

h) ofertuesit, në formën e sipërmarrjes së përbashkët, mbajnë përgjegjësi në mënyrë solidare dhe individuale;

i) kërkohet marrja e miratimit paraprak të Bankës para se të refuzohen të gjitha ofertat dhe të kërkohen oferta të reja;

j) kontratat i jepen ofertuesit kryesisht të kualifikuar, me vlerësimin më të ulët, i cili është vendosur të kualifikohet që të veprojë në përputhje me kriteret e vlerësimit, të përcaktuara dhe të publikuara më parë;

k) nuk lejohet negociimi pas tenderimit me ofertuesin që ka vlerësimin më të ulët apo me ndonjë ofertues tjetër;

l) kontratat e gjata (mbi 18 muaj) përmbajnë dispozita për rregullimin e çmimit të përshtatshëm, të pranueshme për Bankën;

m) sigurimet e ofertave dhe kontratave janë në formatin që përfshihet në dokumentet e tenderit që përmenden në pikën “d” më lart. Sigurimi i ofertës është i vlefshëm deri njëzet e tetë (28) ditë pas përfundimit të periudhës fillestare të vlefshmërisë së ofertës apo pas përfundimit të çdo periudhe të zgjatur, nëse kërkohet. Nuk kryhet asnjë pagesë paradhënie pa një garanci të përshtatshme të pagesës së paradhënies;

n) dokumenti i tenderit dhe kontrata që çmohen të pranueshme nga Banka, përmbajnë dispozita që paraqesin politikën e Bankës për ndalimin e firmave apo individëve, të përfshirë në vjedhje dhe korrupsion, siç është përcaktuar në Udhëzuesin për Prokurimin;

o) në përputhje me Udhëzuesin për Prokurimin, çdo dokument tenderi dhe kontratë që financohet me të ardhura nga Huaja, parashikon që ofertuesit, furnitorët dhe kontraktuesit, si dhe nënkontraktuesit, agjentët, personeli, konsulentët, ofruesit e shërbimeve apo furnitorët e tyre lejojnë që Banka të inspektojë të gjitha llogaritë, dokumentacionin dhe dokumente të tjera, në lidhje me paraqitjen e ofertave dhe zbatimin e kontratës, dhe t’ia nënshtrojë auditimit nga auditues të caktuar

nga Banka. Pa u kufizuar tek dispozitat e paragrafit 1.16 (a) (v) (bb) të Udhëzuesit për Prokurimin, veprimet që synojnë të pengojnë kryesisht ushtrimin nga ana e Bankës të të drejtave të saj për inspektim dhe auditim sipas Udhëzuesit për Prokurimin, përbëjnë një praktikë penguese, siç është përcaktuar në Udhëzuesin për Prokurimin.

C. Metoda të posaçme të prokurimit të shërbimeve të konsulencës

1. Përzgjedhja mbi bazën e cilësisë dhe kostos. Përveç kur parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, shërbimet e konsulencës prokurohen sipas kontratave që jepen sipas përzgjedhjes mbi bazën e cilësisë dhe kostos.

2. Metoda të tjera të prokurimit të shërbimeve të konsulencës. Metodatat e mëposhtme, përveç përzgjedhjes mbi bazën e cilësisë dhe kostos, mund të përdoren për prokurimin e shërbimeve të konsulencës për ato kontrata që përcaktohen qartë në Planin e Prokurimit: a) përzgjedhja mbi bazën e cilësisë; b) përzgjedhja sipas një buxheti fiks; c) përzgjedhja e kostos më të ulët; d) përzgjedhja mbi bazën e kualifikimeve të konsulentëve, e) përzgjedhja me burim të vetëm të firmave të konsulencës; f) procedurat që parashikohen në paragrafët 5.2 dhe 5.3 të Udhëzuesit për Konsulentët, në lidhje me përzgjedhjen e konsulentëve të veçantë; dhe g) procedurat me burim të vetëm për përzgjedhjen e konsulentëve të veçantë.

D. Shqyrtimi nga Banka i vendimeve për prokurimin

Plani i Prokurimit përcakton ato kontrata që janë objekt i shqyrtimit paraprak nga ana e Bankës. Të gjitha kontratat e tjera janë objekt i shqyrtimit të mëpasshëm nga ana e Bankës.”

7. Seksioni IV.B.2, i skedulit 2 ndryshon dhe lexohet si më poshtë:

“2. Data e mbylljes është data 31 korrik 2025.”

8. Seksioni V, i skedulit 2 ndryshon dhe lexohet si më poshtë:

“1. Huamarrësi, nëpërmjet MIE-s, nxit Entin Zbatues të Projektit të sigurojë që çdo studim për projekte urbane, i ndërmarrë në kuadër të pjesës 1 (a) të Projektit, të jetë i pranueshëm për Bankën.

2. Huamarrësi nuk kërkon tërheqje për shpenzime të arsyeshme sipas kësaj Marrëveshjeje: i. të cilat janë financuar ndërkohë me të ardhura nga Marrëveshja e Financimit Shtesë; ose ii. për të



cilat ka kërkuar tërheqje sipas Marrëveshjes së Financimit Shtesë.”.

9. Shtojca ndryshohet si më poshtë:

a) Përkufizimet e mëposhtme ndryshohen dhe lexohen si më poshtë:

““Udhëzuesi për Antikorrupsionin” do të thotë: ose a) “Udhëzuesi për të parandaluar dhe luftuar vjedhjen dhe korrupsionin në projekte të financuara me hua nga IBRD-ja dhe hua e grante nga IDA”, e datës 15 tetor 2006, e rishikuar në janar 2011 dhe më 1 korrik 2016, i zbatueshëm për veprimtari të projektit që financohen me të ardhura nga huaja në apo pas datës së nënshkrimit (përveç atyre të prokuruar sipas Udhëzuesit për Prokurimin apo Udhëzuesit për Konsulentët); ose b) “Udhëzuesi për të parandaluar dhe luftuar vjedhjen dhe korrupsionin në projekte të financuara me hua nga IBRD-ja dhe hua e grante nga IDA”, i datës 15 tetor 2006, i rishikuar në janar 2011, të zbatueshëm për veprimtari të Projektit që financohen me të ardhura nga huaja para datës së nënshkrimit.

“Departamenti për Zhvillim dhe Mirëqeverisje” do të thotë njësi në Zyrën e Kryeministrit, më parë i referuar si Departamenti i Programimit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj, që është ngritur dhe vepron në bazë të urdhrat të Kryeministrit nr. 204, datë 1 nëntor 2013, apo pasuesi i tij.

“Agjencitë Shtetërore Qendrore Pjesëmarrëse” do të thotë “MK”, “MTM”, “MFE” dhe “MIE”.

“Plan Prokurimi” do të thotë plani i prokurimit të Huamarrësit për Projektin, datë 15 korrik 2016 dhe i përmendur në paragrafin 1.18 të Udhëzuesit për Prokurimin dhe paragrafin 1.25 të Udhëzuesit për Konsulencën, dhe i parashikuar sipas seksionit IV të rregulloreve të prokurimit, i cili përditësohet herë pas here me miratimin e Bankës.

“Manual Operacional i Projektit” do të thotë manuali i përmendur në seksionin I. B. 1 (a) të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

“Zona të Përzgjedhura” do të thotë bashkitë e përzgjedhura, korridorit turistik dhe të gjitha zonat e tjera brenda territorit të Huamarrësit, të parashikuara në Manualin Operacional të Projektit.

“Bashki të Përzgjedhura” do të thotë bashkitë e Huamarrësit të parashikuara në Manualin Operacional të Projektit.

“Korridor Turistik” do të thotë rruga e transportit që lidh qytetin e Vlorës me bashkitë e përzgjedhura, siç përshkruhet më tej në Manualin Operacional të Projektit.”.

b) Përkufizimet e mëposhtme janë shtuar dhe lexohen si më poshtë (dhe përkufizimet e mbetura janë riemërtuar për të ruajtur rendin alfabetik):

““Marrëveshje Financimi Shtesë” do të thotë marrëveshja ndërmjet Huamarrësit dhe Bankës për Financimin Shtesë për Shqipërinë, Projekti për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin.

“COVID-19” do të thotë sëmundja e koronavirusit e shkaktuar nga koronavirusi i ri i vitit 2019 (SARS-CoV-2).

“MTM” do të thotë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e Huamarrësit apo pasuesi i saj.

“MFE” do të thotë Ministria e Financave dhe Ekonomisë e Huamarrësit apo pasuesi i saj.

“MIE” do të thotë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Huamarrësit apo pasuesi i saj.

“Rregullore Prokurimi” do të thotë, për qëllime të paragrafit 85, të shtojcës së Kushteve të Përgjithshme, “Rregulloret e Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit FPI”, e korrikut të vitit 2016, e rishikuar në nëntor 2017, gusht 2018 dhe nëntor 2020.

“Datë nënshkrimi” do të thotë data e fundit nga dy datat në të cilat Huamarrësi dhe Banka kanë nënshkruar Marrëveshjen e Financimit Shtesë.”.

c) Përkufizimet e mëposhtme janë fshirë (dhe përkufizimet e mbetura janë riemërtuar për të ruajtur rendin alfabetik): “Plani Vjetor i Punës dhe Buxheti”; “MZHETS”; “MM”; dhe “MF”; “MZHU”.

Të gjitha dispozitat e Marrëveshjes së Huas, përveç atyre të ndryshuara në këtë marrëveshje, mbeten në fuqi dhe efekt të plotë.

Ju lutem tregoni dakordësinë tuaj për sa më sipër, në emër të Huamarrësit, duke sigluar dhe vendosur datën tek të dyja kopjet origjinale të kësaj shkrese që u janë dërguar dhe na ktheni njëjërën kopje origjinale të sigluar.

Dispozitat e parashikuara në këtë shkrese amendimi do të hyjnë në fuqi pasi të jenë përmbushur të gjitha kushtet e hyrjes në fuqi të



Marrëveshjes së Financimit Shtesë. Pas përmbushjes së kushteve të lartpërmendura, Banka do t'i dërgojë Huamarrësit një njoftim për hyrjen në fuqi.

Me respekt,
BANKA NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga: _____

Emanuel Salinas Munoz
Menaxher për Shqipërinë

KONFIRMUAR:
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: _____

Përfaqësuesi i Autorizuar

Datë: _____

SHTOJCA

Skeduli 1

Përshkrimi i Projektit

Objektivat e Projektit janë: a) përmirësimi i infrastrukturës urbane; b) shtimi i aseteve për turizmin; dhe c) fuqizimi i kapaciteteve institucionale për të mbështetur turizmin, në lidhje me zhvillimin ekonomik vendas të Zonave të Përzgjedhura në jug të Shqipërisë.

Projekti konsiston në pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1: Modernizimi urban dhe përmirësimi i infrastrukturës

Modernizimi i infrastrukturës në Zonat e Përzgjedhura me anë të: a) përgatitjes së studimeve të fizibilitetit dhe projekteve (duke përfshirë studimet për projekte urbane); b) kryerjes së punimeve ndërtimore për restaurimin e godinave të

përzgjedhura me vlerë historike; c) zhvillimit të hapësirave publike, rrjetit rrugor dhe infrastrukturës bashkëshoqëruese; dhe d) kryerjes së mbikëqyrjes së ndërtimeve.

Pjesa 2: Zhvillimi i zonave turistike

Përmirësimi i zonave të përzgjedhura turistike përgjatë jugut të Korridorit Turistik të Shqipërisë, mes të tjerash: a) duke restauruar asetet e përzgjedhura kulturore dhe të trashëgimisë, dhe duke krijuar zona pushimi ose pika turistike; b) duke riparuar dhe përmirësuar infrastrukturën e zonave turistike, si rrugët për këmbësorë; c) duke përgatitur studimet e nevojshme të fizibilitetit, planet për menaxhimin e zonave turistike dhe projektet inxhinierike; dhe d) duke kryer mbikëqyrjen e ndërtimeve.

Pjesa 3: Zhvillimi i tregut dhe i produkteve të turizmit

Fuqizimi i kapaciteteve të bashkive për kryerjen e shërbimeve bashkiake dhe mbështetjen e zhvillimit të tregut dhe produkteve të turizmit mes të tjerash, përmes, ndër të tjera: i. sigurimit të pajisjeve për grumbullimin e mbetjeve të ngurta; ii. krijimit të aftësive menaxheriale të zonave turistike për përmirësimin e aktivitetit të aseteve të rehabilituara; iii. përpilimit dhe zbatimit të strategjive për kërkimet në treg dhe krijimin e produkteve; iv. krijimit të partneriteteve institucionale për të nxitur veprimtari të menaxhimit në destinacion, në nivel bashkiak dhe nivel qarku, përfshirë reagimin në rast urgjencash shëndetësore, si p.sh. COVID-19; v. përpilimin dhe zbatimin e statistikave të përmirësuar të turizmit kombëtar në Shqipëri.

Pjesa 4: Mbështetja për zbatimin

Ofrimi i mbështetjes për realizimin e zbatimit të Projektit, duke përfshirë mirëmbajtjen e sistemit për monitorimin dhe vlerësimin e Projektit, si dhe trajnimin dhe financimin e kostove operative.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 144 lekë